



Pranuar / Dërguar / Punëpun / Prodatur / Ruçesur / Delivered	31.12.2021	viti and Year	
Organ / Nësia Organ / Jednica Org / Unit	No. Prot. Pr. Prot. Prot. No.	Shtojta Prilog. Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK/6487/2021			119

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.977/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari- kryetare Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit sipas Aktgjykimit të datës 17.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrativ, te pranuar me date 01.12.2021, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.27/2020 të datës 10.02.2020 të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson avokati Skënder Musa, me adresë: rr. "Luan Haradinaj" nr.19/5 Prishtinë kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.27/2020, e datës 10.02.2020, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Mbetet në Fuqi Vendimi nr. Protokoli 030 i datës 06.01.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave Agjencia Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në pozitën "Udhëheqës i Zyrës Ligjore", në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokoli 315/2020 me datë 10.02.2020, Kundër vendimit me nr. protokoli 030 i datës 06.01.2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 18.02.2020, ka proceduar tek Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale kërkesën për përgjigje në ankesë, ndërsa me datën 25.02.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 07.05.2020, me numër protokollin 808/2020, ka njoftuar ankuesin [REDAKTUAR] se nuk mund të shqyrton dhe vendosë lidhur me ankesën A. Nr. 27/2020, të datës 10.02.2020, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar ankuesin që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi [REDAKTUAR] i pakënaqur me njoftimin e datës 07.05.2020, të Këshillit ka hapur konfliktin administrative pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 17.11.2021, me numër A. Nr. 986/20, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, me të cilin ka anuluar njoftimin e datës 07.05.2020, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendosë lidhur me ankesën A. Nr. 27/2020, të datës 10.02.2020 të ankuesit [REDAKTUAR].

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollin 315/2020 të datës 10.02.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative A.nr.986/20 i datës 17.11.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 18.02.2020; Autorizim i datës 03.12.2019; Pliko me nr. R8858298; E-mailin e datës 07.05.2020; Njoftim i datës 07.05.2020; Përgjigje në ankesë e datës 25.02.2020; Përshkrimi i Detyrave të Punës i vitit 2012; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 01.12.2011; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 01.02.2012; Akt Emërimi i datës 31.01.2012; Vendim i datës 26.06.2012; Kërkesë për ngritje të koeficientit e datës 25.06.2012; Ankesë e datës 06.12.2019; Vendim me nr. protokollin 030 i datës 06.01.2020; Vendim me nr. protokollin 5374 i datës 07.11.2019; E-mail nga C.Z. për D.B. i datës 14.12.2021; E-mail nga D.B. për C.Z. i datës 14.12.2021; E-mail nga L.H. për D.B. i datës 14.12.2021; E-mail nga L.H. për B.K. i datës 08.01.2020; E-mail nga D.B. për C.Z. i datës 14.12.2021; E-mail nga D.B. për C.Z. i datës 14.12.2021; E-mail nga L.H. për D.B. i datës 14.12.2021; E-mail nga D.B. për C.Z. i datës 22.12.2021; E-mail nga C.Z. për D.B. i datës 21.12.2021; Vendim me nr. protokollin 1929 i datës 02.09.2013; Formulari numër 3002/03 viti 2019;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [REDAKTUAR] është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës ankuesi [REDAKTUAR] i punësuar në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale në pozitën "Udhëheqës i Zyrës Ligjore" më datë 25.06.2012 ka bërë kërkesë për ngritje të koeficientit tek Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale me arsyetim se bazuar në parimin e barazisë dhe jo diskriminimit në shërbimin civil si dhe në baze të Rregullores Nr. 09/2012 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimit të Vendeve të Punës, zyra ligjore duhet të jetë e barabartë me departament. Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, më datë 26.06.2012 ka nxjerr Vendim me numër protokollin 1051 me të cilin ka aprovuar kërkesën për ngritje të koeficientit nga koeficienti tetë (8) në koeficientin dhjetë (10).

Me qëllim të adresimit dhe zbatimit të të gjeturave dhe rekomandimeve të adresuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, Ushtruesi i Detyrës së Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale më datë 07.11.2019 ka nxjerr Vendim me numër protokollin 5374 me të cilin e ka shfuqizuar Vendimin me numër protokollin 1051 të datës 26.06.2012.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër protokolli 5374 të datës 07.11.2019 ka parashtruar ankese në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale më datë 06.12.2019. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 06.01.2020 ka nxjerr Vendim me numër protokolli 030, me të cilin vendim e ka refuzuar ankesën e datës 06.12.2020 të parashtruar nga ankuesi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke ju referuar legjislacionit për shërbimin civil respektivisht nenit 18 paragrafit 3 dhe paragrafit 5 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i cili përcakton se: 3. *Pranimi në shërbimin civil në pozicionet e karrierës është i hapur për të gjithë kandidatet për të gjitha pozicionet jo drejtuese në çdo institucion. Për pozicionet drejtuese dhe pozicionet e larta drejtuese, pranimi kryhet nëpërmjet procedurave të ngritjes në detyrë të nëpunësve civilë ekzistues. Në rast se nuk ka kandidatura nga nëpunësit civilë ekzistues, apo kandidatët kanë rezultuar të pa përshtatshëm në përfundim të procesit të konkurrimit, pranimi hapet për të gjithë të interesuarit.* 5. *Për pozita menaxheriale, pranimi bëhet me anë të avancimit të nëpunësve ekzistues civilë*”, si dhe Rregullores nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civil përkatësisht nenit 5 i cili përcakton se: 1. *Shpallja për avancim bëhet nga njësia e personelit brenda institucionit përkatës në vendet e përshtatshme ku kanë qasje të gjithë nëpunësit civilë.* 2. *Shpallja e avancimit fillimisht bëhet brenda njësisë së institucionit.* 3. *Nëse në pozitën e lirë aplikojnë më pak se tre kandidatë të cilët i plotësojnë kriteret sipas kësaj Rregulloreje, njësia e personelit shpall konkurs në nivel institucioni.* 4. *Shpallja duhet të jetë e hapur së paku 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit*, konstaton se ngritja e koeficienteve dhe gradave duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil, Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe akteve nënligjore për zbatimin e ligjit si dhe dispozitat ligjore lidhur me avancimet të përcaktuara me nenin 27 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“1. Avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të:.....1.4 kalimit me sukses të testimit, dëshmimit të meritës, aftësive dhe kompetencës profesionale”*, lidhur me këtë Neni 10 paragrafi 1 i Rregullores Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë ka përcaktuar se: *“1. Koha minimale për avancim nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë ose nga një kategori funksionale më e ulët në kategorinë funksionale më të lartë, është 3 vite kur performanca e nëpunësit civil është vlerësuar mirë dhe shumë mirë, ndërsa 2 vite kur performanca e tij/saj është vlerësuar shkëlqyeshëm”*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të mandatit kushtetues dhe ligjor, për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve dhe veprimeve të organeve të administratës, konstaton se avancimi në karrierë në shërbimin civil duhet të bëhet në mënyrë transparente, të drejtë, të unifikuar, objektive dhe në bazë të meritës së kandidatëve përkatës. Nëpunësit civil ngritën në pozitë në bazë të një procedure të rregulluar dhe vetëm nëse i plotësojnë kushtet specifike të përcaktuara në aktet përkatëse ligjore dhe në bazë të meritës, prandaj ngritja në pozitë nuk bëhet në mënyrë automatike, por vetëm pas një periudhe të caktuar kohore. Ngritja në pozitë mbi bazën e parimit të barazisë dhe jodiskriminimit ose kriterëve të tjera që nuk bazohen në parimin e meritës është e ndaluar, andaj Agjencia Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale me rastin e ngritjes së koeficientit nga tetë (8) në koeficientin dhjetë(10) për ankuesin është dashur të respektoj rregullat dhe parimet e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil, respektivisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Kryeshefi Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr. 1051 të datës 26.06.2012, për ngritjen e koeficientit të ankuesit nga koeficienti tetë (8) në koeficientin dhjetë(10) ka vepruar në kundërshtim me nenin 27 paragrafin 1 nën paragrafin

1.4 të Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe me dispozitat e nenit 10 Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Agjencinë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 030 të datës 06.01.2020 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil U Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes se Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr.977/2021

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BARRAKTARI

Malsore Gashi Barraktari
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit [redacted]
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
- Vjollca Limani Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale ;
- Arkivit të KPMSHCK-

